



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 158, datë 14.04.2021**

**PËR**  
**HAPJEN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM NË**  
**GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS DHE SHPALLJEN E KËRKESËS PËR**  
**KANDIDATURA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61 dhe në shkronjën “c”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 5, të Vendimit të tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

**I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura**

1. Hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.
2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë, për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, për një pozicion të lirë.
3. Afati i paraqitjes së kërkesave për transferim të përkohshëm është deri më datë 21.04.2021.
4. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente :
  - a) Kërkesën për shprehjen e interesit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës;
  - b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
  - c) Fotokopjen e kartës së identitetit;
  - ç) Deklaratën “Për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm” sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi;
  - d) Vetëdeklarimin për mospasjen masë disiplinore në fuqi, zbatimi i të cilës mund të shmanget për shkak të transferimit, sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi;
  - dh) Vetëdeklarimin për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi.
5. Dokumentacioni sipas pikës 4 të këtij vendimi, duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## II. Informacion për kriteret dhe kohëzgjatjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim

6. Kriteret e transferimit të përkohshëm me pëlqim janë si më poshtë:
  - a) Transferimi i përkohshëm nuk duhet të cenojë funksionimin e gjykatës ku kandidati ka caktimin e përhershëm;
  - b) Dobia e transferimit të përkohshëm duhet të jetë më e madhe se efekti negativ që shkaktohet në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;
  - c) Kandidati nuk duhet të jetë i transferuar përkohësisht ose duke shërbyer në skemën e delegimit;
  - ç) Kandidati nuk duhet të jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të përkohshëm;
  - d) Kandidati nuk duhet të gjendet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
7. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim është deri në një vit. Ky transferim mund të përsëritet.
8. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim mund të përfundojë para afatit:
  - a) me kërkesë të gjyqtarit të transferuar përkohësisht, për shkaqe të justifikuara;
  - b) kur vazhdimi i transferimit të përkohshëm do të passillte cenim të funksionimit të gjykatës ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;
  - c) kur dobia e transferimit të përkohshëm është më e vogël se efekti negativ i shkaktuar në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;
  - ç) kur ndaj gjyqtarit të transferuar përkohësisht merret masë disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të tij;
  - d) kur gjyqtari i transferuar përkohësisht jep dorëheqjen nga statusi i magjistratit;
  - dh) kur gjyqtari i transferuar përkohësisht largohet nga detyra.
9. Për shqyrtimin e kërkesave për transferim të përkohshëm me pëlqim, Këshilli i Lartë Gjyqësor ndjek procedurën e përcaktuar në Vendimin e tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar.
10. Transferimi i përkohshëm me pëlqim i gjyqtarit bëhet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**DEKLARATË**  
**PËR**  
**DHËNIE PËLQIMI PËR TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM**

Unë \_\_\_\_\_, aktualisht gjyqtar/e pranë Gjykatës \_\_\_\_\_, me vullnetin tim të lirë, mbështetur në nenin 46 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shpreh pëlqimin tim për transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, sipas Vendimit nr.158 datë 14.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Lëshuar më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021**

**DEKLARUESI**

---

*(Emri, atësia, mbiemri)*  
*(Nënshkrimi)*

## **VETËDEKLARIM**

### **PËR MASA DISIPLINORE**

Unë gjyqtari/ja \_\_\_\_\_ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, sipas Vendimit nr.158 datë 14.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

### **DEKLAROJ SE:**

**Nuk kam masë disiplinore në fuqi, zbatimi i të cilës mund të shmanget për shkak të transferimit.**

Lëshuar më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

### **DEKLARUESI**

---

*(Emri, atësia, mbiemri)*  
*(Nënshkrimi)*

## VETËDEKLARIM

### PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja \_\_\_\_\_ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, sipas Vendimit nr.158 datë 14.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

#### DEKLAROJ SE:

**Nuk do të ndodhem në situatën papajtueshmërisë ambientale** sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lëshuar më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2021

#### DEKLARUESI

---

(*Emri, atësia, mbiemri*)  
(*Nënshkrimi*)